

VENDIM
Nr. 9, datë 27.1.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MBI
VERIFIKIMIN E MATËSAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHE VULOSJEN E TYRE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008, “Për metrologjinë”, i ndryshuar, dhe “Kodit të matjes”, i ndryshuar, nenit 26, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.1.2016, pasi shqyrtoi draftin e kontratës Tip mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria HTT, me shkresën nr. 217 prot., datë 12.1.2016, ka depozituar në ERE propozimin për miratimin e kontratës tip mbi verifikimin e matësve të energjisë dhe vulosjen e tyre.

- ERE, në bazë të nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ka detyrimin të miratojë kontratën Tip mbi verifikimin e matësve të energjisë dhe vulosjen e tyre.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës Tip mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti